



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



KA/Nr. 1070/22 Datë: 15.08.22

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, ta datës 04.09.2020 dhe vendimin 732/22D të datës 03.06.2022 në përbërje të plotë; Faton Berisha kryetar, Muhamet Qerimi anëtarë dhe Haki Demolli anëtarë/rezervë, në prani të procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës së Kolegjit Biznesi me nr.3139/21H, datë 02.09.2021, kundër vendimit të KSHC nr.ref. Ref;3039/21 të nxjerrë me datë 12.08.2021 për zgjatjen e afatit të riakreditimit nga dy (2), në tre (3) vite për programet; *1. Juridik, LLB, 240 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik dhe 2. Menaxhment dhe Financa, MA 120 ECTS, maksimumi 80 studentë për vit akademik.* Në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Rregullores Nr.2/2019 për procedurën e ankesave në Komisionin e ankesave pran AKA si dhe Manualit të Akreditimit, në mbledhjen e datës 25.07.2022, merr:

#### VENDIM

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa e Kolegjit Biznesi me numër protokolli nr.3139/21H, datë 02.09.2021.
- II. I propozohet Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim të ndryshoj vendimin nr.Ref;3039/21 të nxjerrë me datë 12.08.2021, në paragrafin II në të dy pikat (**zgjatet afati i akreditimit nga dy (2) vite sa ishte me këtë vendim, në tri (3) vite**).
- III. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komisionit.

#### ARSYETIM

Kolegjit Biznesi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë me nr.3139/21H, datë 02.09.2021, kundër vendimit të KSHC nr.ref. Ref;3039/21 të nxjerrë me datë 12.08.2021 për zgjatjen e afatit të riakreditimit edhe nga dy (2), në tre (3) vite për programet; *1. Juridik, LLB, 240 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik dhe 2. Menaxhment dhe Financa, MA 120 ECTS, maksimumi 80 studentë për vit akademik.*

Ankuesi në ankesë pretendon se KShC me vendimin Nr.Ref:3039/21, datë 12.08.2021 ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 18 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018, datë 28.09.2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

KShC pas pranimit të ankesës bazuar në nenin 131 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pa u shprehur mbi të, të njëjtnë e ka përcjellë në Komisionin e Ankesave të AKA-së bazuar në paragrafin 5 të nenit 131 të Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

KShC me Vendimin Nr.Ref:3039/21, datë 12.08.2021, ka arsyetuar se është akredituar programi;

- Juridik, LLB, 240 ECTS, për periudhën dy vjeçare, 01.10.2021 - 30.09.2023 me bartësit; Muhamet Racaj, Sejdefa Gjafqë, Arben Agushi, Mitasin Beqiri, Lulzim Farizi kurse
- Menaxhment dhe Financa, MA, 120 ECTS, për periudhën dy vjeçare, 01.10.2021 - 30.09.2023 me bartësit; Ramadan Beqiri, Nexhmije Kabashi, Ariana Xhemajli.

Pastaj në arsyetim thuhet se citoj ; *Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të Ekspertëve Ndërkombëtarë kanë hartuar raportet e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:*

*Për programin e studimit Juridik, LLB, 240 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht katër (4) kapituj dhe pjesërisht tre (3) kapituj.*

*Për programin e studimit Menaxhment dhe Financa, MA 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht katër (4) kapituj dhe pjesërisht tri (3) kapituj.*

Komisioni i Ankesave, pas mbledhjes konstitutive të mbajtur me datë 09.06.2022 njëzëri ka vendosur që të shqyrtoj të gjitha ankesat e parashtruara nga IAL-të për periudhën sa nuk ishte funksional.

Komisioni i ankesave i AKA-së gjatë shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova:

- Ankesë kundër vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nr.:3139/21H, dt. 02.09.2021
- Vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC), Nr.Ref:3039/21, datë 12.08.2021
- Raporti përmbledhës i KShC-së për ankesën
- Raporti i Ekipit të Ekspertëve i datës 24.05.2021, për *Juridik, LLB, 240 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik*
- Raporti i Ekipit të Ekspertëve i datës 06.05.2021 për *Menaxhment dhe Financa, MA 120 ECTS, maksimumi 80 studentë për vit akademik.*

Pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të lartcekura komisioni ka gjetur se në Raportin e Ekipit të Ekspertëve të datës 24.05.2021, në rekomandimin përfundimtar, ekspertët rekomandojnë akreditimin e programit Juridik, LLB për periudhën tri vjeçare (01.10.2021 - 30.09.2024). citojmë

*"In conclusion, the Expert Team considers that the study program LLB. offered by Business College is Substantially Compliant with the standards included in the KAA Accreditation manual and therefore, recommends accrediting the study program for a duration of 3 years with several 50 students to be enrolled in the program".*

Ndërsa për programin e studimit Menaxhment dhe Financa, MA, 120 ECTS, Ekipi i Ekspertëve në Raportin final të vlerësimit të datës 06.05.2021, gjithashtu kishte dhënë rekomandim për akreditim për periudhën tre vjeçare (01.10.2021 — 30.09.2024). citojmë *"In conclusion, the Expert Team considers that the study program MANAGEMENT AND FINANCE MA offered by THE BIZNESI COLLEGE is substantially compliant with the standards included in the KAA Accreditation manual and, therefore, recommends to*

accredit the study program for a duration of 3 years with a number of 80 students to be enrolled in the program".

Komisioni i Ankesave i AKA-së pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe provave të lëndës, pretendimeve të palës ankuese, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe se KShC me Vendimin i Nr.Ref:3039/21, datë 12.08.2021 me të cilin;

Riakreditohen programet e studimit për periudhën dy vjeçare, 1 tetor 2021 - 30 shtator 2023:

- Juridik, LLB, 240 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- Menaxhment dhe Financa, MA 120 ECTS, maksimumi 80 studentë për vit akademik,


nuk ka aplikuar drejtë nenin 18, paragrafi 2 dhe nenin 19 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 15/2018, me ç'rast Komisioni Ankesave konstatoi se referuar raporteve të lartcekur janë plotësuar kushtet për Riakreditim për programet e studimit të lartcekura për periudhën **tre (3) vjeçare, 01 tetor 2021-30 shtator 2024.**

Komisioni Ankesave i AKA, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, provave të ofruara, si dhe analizimit të të gjitha pretendimeve të palës ankuese, ka konstatuar se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës janë të qëndrueshme dhe të bazuara, andaj duke u bazuar në kompetencat e Komisionit të Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të fillojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore Prishtinë-Departamenti për çështje administrative. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës.

Komisioni Ankesave i Agjencisë së Kosovës për Akreditim

Lënda nr.Ref.: 1070/22 datë 15.08.22.

  
Leona Kovaçi

Procesmbajtëse

Vendimi iu dërgohet:

- Ankuesit;
- KShC-së;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Faton Berisha  
Kryetar i Komisionit të Ankesave të AKA

